

ARTAN R. HOXHA

**IDEOLOGJIA, POLITIKA DHE HISTORIA: RASTI
I KRYENGRITJES SË SHQIPËRISË SË MESME
(1914–1915)**

Abstrakt:

Ky punim, duke marrë si rast studimi trajtimin e Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme të viteve 1914-1915, analizon politizimin e historisë gjatë periudhës komuniste dhe përdorimin e saj si instrument i legjitimit të regjimit stalinist shqiptar. Një hapësirë e posaçme i është kushtuar sidomos ndërhyrjes së Enver Hoxhës mbi mënyrën e trajtimit të kësaj kryengritjeje dhe tezave që ai hodhi për interpretimin e saj. Në këtë artikull, argumentohet se udhëheqësi komunist shqiptar e integroi Kryengritjen e Shqipërisë së Mesme brenda një skeme historike teleologjike, që kishte për synim të justifikonte dhe legjitimonte të tashmen nëpërmjet së shkuarës. Sipas E. Hoxhës, lëvizja e armatosur e drejtuar kundër Princ Vidit dhe Esat Pashë Toptanit ishte një luftë me karakter klasor, të cilën fshatarësia shqiptare e drejtonte kundër Fuqive të Mëdha europiane dhe klasës së bejlerëve që u shërbente interesave të huaj në Shqipëri. Për rrjedhim, lufta për emancipimin kombëtar dhe klasor integroheshin në një emërues të vetëm. Kryengritja e Shqipërisë së Mesme i shërbente Enver Hoxhës për të ndërtuar një traditë revolucionare në Shqipëri, pika kulmore e së cilës ishte qëndresa e drejtuar prej komunistëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Nevoja për të treguar se themelimi i PKSh-së dhe ardhja në pushtet e saj nuk ishin aksidente historike por rezultat i logjikës së vetë historisë së Shqipërisë, ishte arsyeja pse E. Hoxha i dha Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme një rëndësi shumë të madhe dhe të përcaktonte personalisht mënyrën e trajtimit të saj.

Fjalë kyçe:

Enver Hoxha, Kryengritja e Shqipërisë së Mesme, fshatarësia, proletariati, borgjezia, çifligarët, materializmi historik, ideologjia, politika, Karl Marksi, marksizëm-leninizmi.

Te Ura, te Ura
 Vraponi, o burra
 Me armë, me topa, me kordha' e me shpata
 Se dolli kuçedra e errët nga nata,
 Se ngriti bajrakun e lyer me gjak
 Dhe sulet prej Shijakut në Durrës me vrap

Kuçedra e thyer,
 Me turp e përlyer
 Përmblihet e kthehet nga toka në Durrës
 Dhe ngrihet m' e fortë në Gjol, afër Urës
 Shqiptar' i verbuar vërsulet në det,
 Shkel Flamur dhe Nënë dhe vllazër po vret.

Këto janë dy strofat e para nga poezia epike e Fan Nolit “Tomsoni dhe kuçedra”, ku intelektual i poliedrik shqiptar heroizon komandantin holandez të xhandarmërisë shqiptare Lodewijk Thomson, të rënë më 15 qershor të vitit 1914 në përleshje me forcat që ishin ngritur kundër qeverisë së Wilhelm Wied-it.¹ Ajo që ka rëndësi për këtë sprovë, nuk është edhe aq qëndrimi i Nolit ndaj kësaj lëvizjeje, që nuk ndryshon nga ai i intelektualëve nacionalistë bashkëkohës shqiptarë, se sa fakti se qysh nga vendosja e komunizmit kjo poezi do të botohej për herë të parë vetëm në vitin 1987. Botimi i kësaj poezie ishte një sinjal i atyre përpjekjeve të druajtura për të reformuar sistemin stalinist shqiptar, që kërkoi të zbatonte kreu komunist shqiptar i kohës, Ramiz Alia. Udhëheqësi i ri i regjimit të Tiranës po rrekej të lironte darët dogmatike staliniste përmes të cilave Enver Hoxha kishte shtrënguar shoqërinë shqiptare për dekada të tëra. Në këtë poezi, Noli vinte në shënjestër dhe stigmatizonte Kryengritjen e Shqipërisë së Mesme, të cilën ai e paraqiste si një fatkeqësi kombëtare. Simbolikisht, botimi i kësaj poezie shënonte pikënisjen e një kthese pasi qëndronte në antitezë me historiografinë

¹ Fan S. Noli, *Vepra*, vëll. I, Tiranë: 8 Nëntori, 1987, f. 68-69.

komuniste shqiptare, e cila e paraqiste këtë kryengritje si një lëvizje përparimtare.

Vlerësimin e saj si të tillë e kishte bërë vetë Enver Hoxha, i cili, në vitin 1962 ndërhyri personalisht për të imponuar këtë tezë mbi historianët shqiptarë, të cilët, pas shqyrtimit të lëndës burimore, kishin arritur në përfundimin se kjo kryengritje kishte pasur karakter reaksionar dhe antikombëtar.² Nga ky moment, qëndrimi i udhëheqësit komunist shqiptar u bë edhe varianti zyrtar në të gjitha tekstet historike dhe mbeti i tillë deri në rënien e komunizmit.³ Pse duhej të ndërhynte Enver Hoxha për të përkufizuar karakterin e kësaj kryengritjeje? A ishte në të vërtetë kjo lëvizje kaq e rëndësishme sa të shtynte kreun komunist shqiptar që, jo thjesht të orientonte qëndrimin e historianëve shqiptarë, por që të shkruante madje personalisht mbi këtë kryengritje? Ishte dëshira e Enver Hoxhës që të thoshte fjalën e fundit për gjithçka apo ishte paaftësia e historianëve shqiptarë për të interpretuar këtë ngjarje të historisë së vendit tonë në përputhje me ideologjinë marksiste-leniniste?

Duke folur për qëndresën e drejtuar prej komunistëve gjatë Luftës së Dytë Botërore, Bernd J. Fischer me të drejtë ka argumentuar se për Enver Hoxhën historia ka shërbyer si mjet i rëndësishëm për legjitimin e pushtetit të tij dhe, sipas tij, rezistenca partizane kishte rëndësi kapitale në narrativën e ngritur nga regjimi komunist shqiptar.⁴ Ashtu sikurse do të shihet edhe më poshtë, është e vërtetë se për kreun e regjimit komunist shqiptar Lufta e Dytë Botërore ishte momenti më i lavdishëm i historisë së shqiptarëve. Por duhet pasur parasysh se, sipas narrativës që ndërtuan autoritetet komuniste, ky moment nuk ishte viti zero, por pika kulmore e një zhvillimi të gjatë historik. PPSH-ja legjitimonte pushtetin e saj pikërisht duke paraqitur veten si përfaqësuese të forcave të thella historike. Për këtë arsye, që të kuptohet më mirë raporti ndërmjet historisë dhe politikës në Shqipërinë komuniste duhet eksploruar me

² Mbi një parashtrim të hollësishëm të këtij problemi mbështetur mbi të dhënat arkivore, shih Sonila Boçi, "Kujtesa kolektive si pjesë e ideologjizimit të shqiptarëve", *Studime historike*, nr. 3-4, QSA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2013, f. 179-198. Më konkretisht, mbi çështjen e lëvizjes së armatosur të Shqipërisë së Mesme në vitet 1914-1915, shih f. 186-191.

³ Arben Puto, "Enver Hoxha si e bëri Haxhi Qamilin patriot", *Gazeta Shqiptare*, shtojca "Milosao", 12 korrik 2009, f. III.

⁴ Bernd J. Fischer, "Politizimi i historisë: Rasti i Shqipërisë në Luftën e Dytë Botërore", në *Politika dhe historia*, bot. Fatos Tarifa, Romeo Gurakuqi & Ermal Hasimja, Tiranë: UET Press, 2011, f. 185-200.

kujdes i gjithë konstrukti i së shkuarës që ngriti aparati komunist shqiptar si dhe gurra ideologjike e tij. Kryengritja e Shqipërisë së Mesme shërben si një rast shumë i rëndësishëm studimor për të analizuar skemën historike që u ngrit nga struktura e pushtetit të PPSH-së dhe ku Enver Hoxha ka pasur një rol të dorës së parë në ndërtimin e saj.

Ndërhyrja e autoriteteve politike në shkrimin e historisë nuk është një dukuri thjesht shqiptare apo që shfaqet vetëm në diktaturat e tipit komunist. Qysh në krye të herës, lëmi akademik i historishkrimit ka qenë ngushtësisht i lidhur me politikën, aq sa në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX qarkullonte gjerësisht postulati se “historia është politika e së shkuarës dhe politika është historia e së tashmes”. Rajonet e Europës Qendrore, Lindore dhe Juglindore kanë ofruar një mjedis ideal për kryerjen me sukses të sintezës ndërmjet historisë dhe politikës. Siç do të vinte në dukje në vitin 1922 historiani britanik Robert William Seton-Watson, në këto pjesë të kontinentit të vjetër, e tashmja është përdorur si mjet për të shpjeguar të shkuarën.⁵ E thënë ndryshe, politika dhe nevojat e atyre që e mbajnë atë nën kontroll, kanë diktuar mënyrën se si e shkuara është kuptuar, shkruar dhe interpretuar. Shtetet e reja kombëtare të këtij rajoni, të dala nga rrënojat e perandorive të Romanovëve, Hohenzollerëve dhe Osmanëve, ishin të dobëta ekonomikisht e ushtarakisht, me institucione të pakonsoliduara, të cilat kishin nevojë të legjitimoheshin. Kalimi nga perandori që sundoheshin nga dinastë që mbanin titullin e Cezarit (Car apo Kaizer) e të Kalifit të shtete që mëtonin se përfaqësonin të drejtën e kombeve për të pasur një jetë politike të mëvetësishme, paraqiste vështirësi tejet të mëdha për legjitimimin e elitave kombëtare. Historia, si narrativë që justifikon rendin ekzistues, luante një rol qendror për të legjitimuar shtetet e reja kombëtare. Me vendosjen e regjimeve komuniste, kësaj tradite iu mbivendos determinizmi historik marksist.

Në teorinë e materializmit historik, Karl Marksi mëtoi se të gjitha shoqëritë njerëzore, pavarësisht qytetërimit dhe kulturës, lëviznin nëpër një trajektore të vetme unlineare evolutive të ndarë në pesë faza mbështetur mbi format e organizimit të prodhimit dhe të llojit të pronës. Në drejtim kronologjik nga shkalla më e ulët tek ajo më e lartë, këto formacione sociale (ose rende) ishin komuna primitive, rendi skllavo-

⁵ Robert Williams Seton-Watson, *The historian as a political force in Central Europe*, London: Eyre and Spottiswoode, 1922, f. 16.

pronar, feudalizmi, kapitalizmi dhe komunizmi.⁶ Ky i fundit ishte destinacioni i historisë, forma më e lartë e organizimit ekonomiko-shoqëror ku njerëzit do të shpalosnin të gjitha potencialet e tyre. Kalimi nga njëri rend në tjetrin bëhej përmes revolucioneve, të cilat ishin lokomotiva e historisë, dhe ishin shprehje e luftës së klasave, tipar dallues i shoqërive të qytetëruara ku mbizotëronte pabarazia ekonomike dhe politike dhe që ishin të ndara në klasa. Ky interpretim i së kaluarës njerëzore dhe realitetit social e cilësonte shtetin si instrument dhune i dominimit klasor. E thënë ndryshe, për Marks, shteti ishte një aparat represiv diktatorial që nuk qëndronte mbi klasat dhe nuk ishte medium i negociimit të interesave të segmenteve të ndryshme sociale, por shprehje e interesave të grupit dominues që përdorte aparatit e shtrëngimit apo dhunën për të mbrojtur interesat e tij.

Sipas teorisë marksiste, shteti do të zhdukej vetëm me eliminimin e klasave dhe kjo do të ndodhte vetëm kur të arrihej komunizmi. Por perioda e kalimit nga kapitalizmi në komunizëm, që do të kryhej nëpërmjet revolucionit të klasës punëtore, nuk do të shënonte fundin e shtetit por themelimin e një shteti të tipit të ri. E për sa kohë kishte shtet, do të kishte edhe diktaturë, vetëm se nuk do të ishte e borgjezisë por e proletariatit. Klasat do të treteshin gradualisht dhe bashkë me të edhe lufta e klasave. Rrugëtimi drejt kësaj pikëmbërritjeje, që do të shënonte edhe fundin e historisë, ku shteti si mjet i pushtetit të punëtorëve do të qëndronte në këmbë, do të quhej socializëm.⁷ Sipas Marksit, kalimi nëpër këto etapa, përfshi këtu edhe vendosjen e shtetit socialist ishte e paracaktuar nga ligjet e historisë, që ai i mendonte se i kishte parashikuar me saktësi shkencore.

Edhe pse në fund të jetës së tyre, si Marksi ashtu edhe bashkëpunëtori i tij i ngushtë, Fridrih Engels, lanë të kuptonin se kjo skemë nuk ishte domosdoshmërisht e aplikueshme kudo, bolshevikët, pasi morën pushtetin në Rusinë cariste e kthyen këtë model të zhvillimit historik në një doktrinë universaliste, e cila u kthye në një pikë reference

⁶ Archie Brown, *The Rise and Fall of Communism*, New York: Harper & Collins, 2009, f. 21; Samuel Enoch Stumpf, *Filozofia – Historia dhe problemet*, shqipëroi nga anglishtja Kastriot Myftiu dhe Paqsor Shehu, Tiranë: Toena, 2002, f. 405; Arthur F. McGovern, *Marxism: an American Christian Perspective*, Maryknoll, NY: Orbis Books, 1980, f. 26-34.

⁷ *A Dictionary of Marxist Thought*, bot. Tom Bottomore, Cambridge, MA: Harvard University Press, 1983, f. 129-130, 444-446, 485-487.

në të gjitha vendet e Bllokut Socialist. Vetëm se komunistët sovjetikë bënë disa ndryshime thelbësore që u përputheshin interesave të tyre. Në kontradiktë me modelin marksist, duke nisur nga Lenini bolshevikët kryen revolucionin e tyre në një vend agrar që nuk kishte kaluar ende në shkallën e një demokracie borgjeze duke i bërë apel fshatarësisë ruse dhe duke i premtuar asaj tokën.⁸ Justifikimin e gjetën duke iu referuar Marksit dhe manipuluar skemën e tij të evolucionit të historisë, tek e cila gjenin edhe burimin kryesor të legjitimitetit të tyre.⁹

Në një varg veprash, si “Ç’janë miqtë e popullit dhe si luftojnë ata kundër socialdemokratëve”,¹⁰ “Zhvillimi i kapitalizmit në Rusi”¹¹ etj., Lenini u përpoq të vërtetonte se aleanca mes proletariatit urban dhe fshatarësisë nuk ishte e panatyrshme, për shkak se ekonomia e mallrave kishte depërtuar edhe në fshatin rus. Këtu ishin shfaqur të gjitha ato dukuri që dallonin zhvillimin kapitalist, siç është orientimi i prodhimit për tregun e brendshëm, vendosja e fshatit në orbitën e qytetit, varfërimi i shumicës dhe pasurimi i pakicës, shpronësimi masiv i fshatarësisë dhe përqendrimi i pronës gjithmonë e në më pak duar, mekanizimi i bujqësisë, lindja e industrialistëve fshatarë, përdorimi i punës me mëditje në fshat. Këto transformime krijonin kontingjentin e proletariatit rural dhe urban, që ishin fshatarët që migronin në qytet. Përpjekja për të treguar se kushtet e brendshme në Rusinë e Romanovëve ishin pjekur për revolucionin proletar i shërbenin si Leninit dhe pas tij Stalinit, të mëtonin se triumfi i Partisë Komuniste të BRSS-së nuk ishte rezultat i koniunkturave historike të krijuara nga Lufta e Parë Botërore por, një rrjedhojë e pashmangshme e ligjeve të historisë dhe e transformimit kapitalist të shoqërisë ruse. Pasi konsolidoi pushtetin e tij në krye të Kremlinit, Stalini, njëlloj si edhe Lenini, e ngriti historinë në rangun e hyjnisë dhe i shndërroi strukturat e pushtetit të komanduar prej tij në

⁸ John M. Thompson, *Revolutionary Russia, 1917*, Prospect Heights, Ill: Waveland Press, 1997, f. 158-189.

⁹ Për një kritikë të skemës historike të bolshevikëve, sidomos asaj të kristalizuar gjatë kohës së qeverisjes së Bashkimit Sovjetik nga Stalini, shih Karl A. Wittfogel, *Despotizmi oriental: studim krahasues i pushtetit total*, shqipëroi nga anglishtja Bashkim Shehu, Tiranë: Toena, 1999.

¹⁰ Vladimir I. Lenin, “Ç’janë “Miqtë e popullit” dhe si luftojnë kundër socialdemokratëve?”, në *Vepra të zgjedhura*, vëll. I, Tiranë: 8 Nëntori, 1977, f. 55-125.

¹¹ Vladimir I. Lenin, “Zhvillimi i kapitalizmit në Rusi”, në *Vepra*, vëll. III, Instituti i Historisë së Partisë, Tiranë: 1959.

mjete për përmbushjen e logjikës dhe të qëllimit të saj. Skematizimi i historisë dhe pretendimi se ajo shërbente si një instrument shkencor që parashikonte në mënyrë të pagabueshme të ardhmen, ofronin për udhëheqësit sovjetikë një narrativë që legjitimonte pushtetin e tyre.

Po njëlloj si edhe në Bashkimin Sovjetik, edhe në Shqipëri, skema marksiste e historisë haste në probleme të mëdha për të shpjeguar vendosjen e diktaturës së proletariatit në një vend me ekonomi agrare dhe me industri ende në shkallë embrionale dhe me një klasë punëtore që zinte një përqindje të papërfillshme në numrin e përgjithshëm të popullsisë së vendit¹² - e gjithashtu edhe në shumicën e vendeve të Europës Lindore, me përjashtim të Çekoslovakisë dhe Gjermanisë Lindore. Shqipëria nuk kishte përjetuar transformime ekonomike, shoqërore dhe politike të tilla, që të kishin tronditur me themel strukturën sociale dhe jetën e popullsisë rurale. E thënë ndryshe, kapitalizmi nuk kishte bërë ende hapa vendimtarë brenda shoqërisë shqiptare. Ndërkaq, në përputhje me modelin që parashikonte Marksi, që Shqipëria të bëhej socialiste, duhej së pari të transformohej në një vend me ekonomi kapitaliste dhe të dominohej politikisht dhe kulturalisht nga borgjezia.

Për këtë arsye, autoritetet komuniste shqiptare u detyruan të bënin akrobaci për të vërtetuar se Shqipëria kishte kaluar nëpër të gjitha fazat e nevojshme historike - përfshi këtu edhe revolucionet përkatëse që kishin mundësuar kalimin nga një shoqëri gjysmëçifligare (që historiografia shqiptare e emërtonte si feudalo-borgjeze) drejt një regjimi që pretendonte se përfaqësonte ideologjinë e proletariatit dhe qeveriste në emër të këtij të fundit. Kështu, historia e Shqipërisë iu nënshtrua një skeme të diktuar nga nevojat e autoriteteve politike. Ndërsa pretendonin se zbatonin një teori shkencore dhe materialiste të zhveshur nga çdo lloj ndikimi prej filozofisë dhe rrymave idealiste, në fakt, regjimi i interpretoi dhe i gjykoi ngjarjet historike në mënyrë dogmatike dhe *apriori*. Paralelisht me forcimin e pushtetit të tij dhe ngritjen e regjimit stalinist, Enver Hoxha filloi t'u mësonte shqiptarëve historinë sipas versionit të tij.¹³

Kryengritja e Shqipërisë së Mesme ishte pjesë e rëndësishme e skemës së narrativës historike që Enver Hoxha u kujdes të ngrinte për të

¹² *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. III (1925-1939), ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2020, f. 383-443; Demir Dyrmishi, *Punëtorët në Shqipëri (1944-1960)*, Tetovë: Album, 2001, f. 21-45.

¹³ Dritan Egro, *Historia dhe ideologjia*, Instituti i Historisë, Tiranë: Maluka, 2007, f. 98.

legjitimuar pushtetin e tij. Udhëheqësi stalinist shqiptar dhe strukturat e prodhimit të dijes, e konsideruan këtë kryengritje si momentin e parë të luftës së klasave në suazat e shtetit shqiptar të pavarur e të shkëputur nga Perandoria Osmane dhe e drejtuar kundër klasës së çifligarëve si rezultat i depërtimit të marrëdhënieve kapitaliste në bujqësi. Tashmë, Shqipëria kishte një lëvizje fshatare, të ngjashme me ato të vendeve të tjera me tradita revolucionare, si dhe një Pugaçov, një Panço Vila apo një Tomas Myncer. Homologu shqiptar i këtyre udhëheqësve të njohur revoltash fshatare ishte Haxhi Qamili.

Sipas zërit zyrtar të historiografisë marksiste shqiptare, meqenëse Shqipëria ishte një vend agrar, pjesën dërrmuese të popullsisë shqiptare e përfaqësonte fshatarësia, gjë që e bënte atë një aktor të dorës së parë në luftën për pavarësi.¹⁴ Kjo ishte arsyeja pse Enver Hoxha, kur vinte puna për fshatarësinë, shprehej: “Mund të themi se deri para disa dhjetëvjeçarëve historia e fshatarësisë shqiptare është gati historia e popullit shqiptar. Të gjithë e dimë se gjatë zhvillimit të shoqërisë në Mesjetë por edhe më vonë, çështja e fateve të atdheut ka qenë e lidhur ngushtë me fshatarësinë, sepse fshatarësia përbënte shumicën dërrmuese të popullit, ajo luftonte për tokën, për mbrojtjen e atdheut”.¹⁵ Ky përkufizim ecte në përputhje të plotë me njërin prej shtyllave kryesore të metodologjisë marksiste për interpretimin e historisë – që historia kryhet prej masave dhe jo prej individëve, roli i të cilëve kufizohej vetëm në shprehjen e interesave të përgjithshëm materialë të klasave shoqërore që ata përfaqësonin.

Kryengritjet e fshatarësisë shqiptare që mbushnin analet e historisë së periudhës osmane, udhëheqësi stalinist shqiptar i shihte si luftë, që shumica dërrmuese e popullsisë së vendit kishte bërë për tokën. Këtë ide, ai e artikuloi qysh në vitin 1948, kur në fjalimin që mbajti në Kongresin e Parë të PPSH-së theksoi se “lufta e fshatarësisë s’onë për tokën dhe për çlirim ka qenë shekullore.”¹⁶ Pra, interesat ekonomikë të fshatarësisë ndërthureshin me ata kombëtarë duke shkruarë kështu, në një emërues të vetëm, luftën çlirimtare me atë të klasave. Deri para Shpalljes së

¹⁴ Gazmend Shpuza, *Kryengritja fshatare e Shqipërisë së Mesme 1914-1915*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1986, f. 13.

¹⁵ *Po aty*, f. 14.

¹⁶ Enver Hoxha, *Raport në Kongresin e I-rë të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Mbi punën e Komitetit Qendror dhe detyrat e reja të Partisë*, Botim i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Tiranë: 1949, f. 15.

Pavarësisë lufta e klasave ishte kryer në kuadrin e luftës kundër pushtuesit, e cila i jepte konfliktit klasor edhe natyrën e një lëvizjeje me karakter çlirimtar. Ngërthimi i përpjekjeve për emancipimin nga ajo që cilësohej si zgjedha e dyfishtë feudale dhe kombëtare, do të bëhej i plotë gjatë periudhës së Rilindjes. Sipas historiografisë marksiste shqiptare “fenomeni më i rëndësishëm i Rilindjes ishte kontradikta mes pushtuesve osmanë dhe popullit shqiptar dhe ajo mes feudalëve dhe fshatarëve”.¹⁷

Deri në çastin e Shpalljes së Pavarësisë fshatarësia kishte luftuar kundër fisnikërisë së tokës, që historiografia marksiste shqiptare i etiketonte si “feudalë” dhe “çifligarë”, të cilët shiheshin jo vetëm si shfrytëzues të punës së saj por edhe si bashkëpunëtorë të pushtuesit osman,¹⁸ e si përfaqësues të tij. Sipas E. Hoxhës, qëndrimi i parisë së vjetër shqiptare do të ndryshonte “në pragun e shpartallimit të perandorisë turke,” pasi “bejlerët e vëndit marin flamurin e nacionalizmit të vetë qeverimit, me qëllim që të ruanin dhe të konsolidonin pozitat e tyre ekonomike dhe politike.”¹⁹ Historiografia shqiptare e përvetësoi përfundimin e kreut të regjimit. Në tekstin e saj zyrtar të vitit 1984, ku jepte metanarrativën e historisë së Shqipërisë, argumentohej se përfshirja e parisë së lidhur me tokën në lëvizjen kombëtare u bë e mundur në saje të dobësisë së borgjezisë shqiptare, e cila duke qenë tepër e brishtë ekonomikisht ishte e shtrënguar të ndante udhëheqjen e lëvizjes kombëtare me çifligarët.²⁰ Kjo aleancë - që përputhej me analizën që Marksist dhe Engelsi përdorën për të ashtuquajturën marrëveshje mes “thekrës dhe çelikut”, pra mes junkerëve prusianë dhe borgjezisë tregtare dhe industrialiste gjermane, ku të dytët hoqën dorë nga pushteti politik dhe në shkëmbim ruajtën të drejtën të shtonin kapitalin e tyre - u shfaq në Shpalljen e Pavarësisë dhe u pasqyrua edhe në përbërjen e organeve shtetërore të Qeverisë së Vlorës.²¹

Teza e aleancës çifligaro-borgjeze, së cilës i kundërvihej ajo e punëtorëve dhe e fshatarëve, bazohej gjithashtu edhe te konkluzionet që Internacionalja Komuniste do të përcaktonte në vitin 1922 lidhur me

¹⁷ D. Egro, *Historia dhe ideologjia ...*, f. 185.

¹⁸ G. Shpuza, *Kryengritja fshatare ...*, f. 422.

¹⁹ E. Hoxha, *Raport në Kongresin e I-rë ...*, f. 17.

²⁰ *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Historisë, Tiranë: 8 Nëntori, 1984, f. 85.

²¹ *Po aty*, f. 35.

luftën klasore në vendet e kolonizuara të Lindjes.²² Kjo skemë do të pasqyrohej edhe në historiografinë shqiptare. Në veprën më të rëndësishme kushtuar Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme, të shkruar nga historiani Gazmend Shpuza thuhet: “Lidhjet tregtare me vendet e tjera ndikuan në orientimin divergjent të qarqeve borgjeze shqiptare. Borgjezia e pasur shqiptare, duke u shndërruar vetëm një pjesë fare e vogël e saj në borgjezi industriale, mbeti një klasë e dobët ekonomikisht dhe politikisht. Prandaj edhe pikpamjet e mjaft përfaqësuesve të saj në këtë drejtim afronin shume ose qenë edhe të njëjta me ato të reaksionit çifligar, bajraktar dhe klerikal.” Dhe më tej vijohej: “Pikpamjet e përfaqësueve të reaksionit çifligar e borgjez ndaheshin në çështjen se cili do të ishte shteti që do të siguronte mbrojtjen e regjimit çifligaro-borgjez të vendit....Këto pikpamje u shfaqën qartë fill pas Shpalljes së Pavarësisë së atdheut. Shumica e përfaqësuesve të reaksionit çifligar e borgjez ishte e natyrshme të shpresonte tek Austro-Hungaria dhe tek Italia”.²³

Enver Hoxha, dhe pas tij edhe historiografia komuniste shqiptare, e cilësuan karakterin fetar që mori Kryengritja e Shqipërisë së Mesme si një tipar të fituar në proces e sipër dhe për këtë fajin e kishte dobësia e borgjezisë vendëse. Duhet theksuar se fillimisht historianët shqiptarë nuk e pranuan këtë tezë. Në vitin 1962, në diskutimin që pati me udhëheqësin e PPSH-së, kryeredaktori i maketit të vëllimit II të Historisë së Shqipërisë, profesor Stefanaq Pollo, argumentoi se Kryengritja e Shqipërisë së Mesme ishte një lëvizje reaksionare, antishqiptare dhe proturke, e cila vuri në dyshim ekzistencën e shtetit të sapoformuar shqiptar. Enver Hoxha kundërgumentoi se në Shqipërinë e Mesme nuk pati asnjë kryengritje drejtuar kundër qeverisë së Ismail Qemalit por ajo u drejtua kundër Vilhelm Vidit dhe Esat Pashë Toptanit,²⁴ e cila ishte shenjë se kryengritja u drejtua kundër çifligarëve, të cilët donin të ruanin pozitën e tyre përmes nënshtimit të vendit ndaj interesave të huaj. Pas këtij diskutimi, Enver Hoxha bëri një shkrim të gjatë mbi Kryengritjen e Shqipërisë së Mesme, ku përcaktoi edhe qëndrimin e historiografisë shqiptare mbi karakterin e kësaj lëvizjeje.

Sipas Hoxhës, çarja e madhe ndërmjet borgjezisë, e cila për shkak të interesave të saj bashkëpunonte me çifligarët dhe fshatarësinë bëri që kjo

²² Iv Gyshe, Zhan–Mari Dë Maldan, *Historia e ideve politike*, vëll. II, Pejë: Dukagjini, 2005, f. 355.

²³ G. Shpuza, *Kryengritja fshatare ...*, f. 65.

²⁴ A. Puto, “Enver Hoxha si e bëri Haxhi Qamilin patriot ...”, f. 2-3.

e fundit të mbetej vetëm. E mbetur e vetme dhe pa udhëheqje, kryengritësit shfaqën të gjitha dobësitë dhe kufizimet ideologjike që karakterizonin botëkuptimin fshatar. Distançimi i borgjezisë dhe i intelektualëve nga lëvizja e popullsisë rurale të Shqipërisë së Mesme ishte arsyeja që kjo, në kushtet e padijes dhe injorancës të mbështetej tek ideologjia fetare dhe ta shpjegonte luftën e saj klasore përmes thjerrave të fesë. Kjo lejoi që në radhët e saja të depërtonin bashkudhëtarë të rastit, siç ishin edhe krerët turkomanë si Mustafa Ndroqi dhe Musa Qazimi. “Populli shqiptar me të drejtë në ato kohë – shkruante Enver Hoxha – kishte nevojë për udhëheqje, pse ishte prapa, pra, edhe fshatarët e Shqipërisë së Mesme kishin nevojë për udhëheqje”.²⁵ Por kjo udhëheqje mungoi dhe fajtorë për këtë nuk ishin fshatarët por borgjezia dhe atdhetarët intelektualë, të cilët nuk ditën të bashkëpunonin me fshatarësinë, ta udhëhiqnin atë. Siç do të shkruante edhe Hoxha në një shkrim kushtuar kësaj kryengritjeje: “Kishte mjaft gjëra që “rebelët” nuk i kuptuan, por edhe të tjerët (e kam fjalën për patriotët) nuk i kuptuan “rebelët”, nuk u futën te “rebelët”, që të lidheshin me ta e me influencën e tyre të mos lejonin ato gabime që u vërtetuan. Në qoftë se ata në fillim u nxitën nga intrigat e Esat pashë Toptanit, nuk duhet t’ia hedhim fajin njerëzve që morën armët, por dobësive të krerëve demokratë borgjezë dhe patriotëve të asaj kohe, që, pas Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, nuk ditën si duhet që të kapeshin pas shtresave kryesore, pas masës së fshatarësisë, si Skënderbeu 25 vjet me radhë”.²⁶

Në këtë mënyrë, luftën e klasave fshatarësia do ta shpjegonte në përputhje me botëkuptimin e saj, me shkallën e zhvillimit të saj intelektual, që ishte feja. Në formulimin e këtij përfundimi Enver Hoxha u mbështet në librin e njohur të Frederik Engelsit “Lufta fshatare në Gjermani”, kushtuar revoltave të viteve 1524-1525 të kryera në kohën e Reformacionit e të drejtura nga teologu radikal Tomas Myncer. Enver Hoxha identifikonte shumë ngjashmëri ndërmjet Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme të viteve 1914-1915 dhe asaj gjermane të shek. XVI, veçanërisht te fryma fetare që këto kishin. Lidhur me kryengritjen fshatare gjermane Engelsi do të thoshte se fakti “që kjo luftë klasash bëhej atëherë nën parullat fetare dhe që interesat, nevojat dhe kërkesat e

²⁵ Enver Hoxha, “Disa pikëpamje mbi Kryengritjen e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme (1914-1915), të udhëhequr nga Haxhi Qamili,” *Për shkencën*, Tiranë: 8 Nëntori, 1985, f. 124.

²⁶ Po aty, f. 128.

klasave të ndryshme fshiheshin nën mbulesë fetare, kjo nuk e ndryshon aspak thelbin e çështjes dhe shpjegohet lehtë me kushtet e kohë,”²⁷ me kushtet e një bote që po shkundte pluhurin e Mesjetës. Ky shpjegim përshkon qëndrimin e Enver Hoxhës në analizën që ai i bën parullave fetare të hedhura nga kryengritësit fshatarë të Shqipërisë së Mesme. Feja ishte petk që vishte dhe fshihte luftën e klasave.

Kështu, shkëputjen nga Perandoria Osmane historiografia komuniste shqiptare e cilësoi si “një revolucion gjysmak i borgjezisë shqiptare, e cila hyri në aleancë me çifligarët e borgjezuar”.²⁸ Ajo nuk solli asnjë ndryshim në gjendjen ekonomiko-shoqërore të fshatarësisë pasi nuk e përmbysi pushtetin e klasës së çifligarëve, të cilët, bashkimin me lëvizjen kombëtare e shihnin si taktikë për të mbrojtur të paprekura pozitat dhe interesat e tyre në kushtet kur korniza shtetërore ndryshoi dhe Perandoria Osmane reshti së qeni binaja shtetërore ku ata mund të ushtronin pushtetin e tyre. Pra, revolucioni kombëtar nuk arriti të shndërrohej në revolucion agrar dhe social,²⁹ i cili bëhej i domosdoshëm në kushtet kur shumica dërrmuese e popullsisë ishte fshatare. “Klasa fshatare,” shkruante Enver Hoxha, “ishte Shqipëria, ajo prodhonte, por ajo vuante dhe harrohej”.³⁰ E thënë ndryshe, sipas kreut komunist shqiptar, shteti i pavarur shqiptar nuk i dha fund çështjes agrare por e la atë pezull. Për rrjedhim, në kuadrin e një qeverie përfaqësuese ku fshatarësia mbetej e papërfaqësuar dhe ku honi ndërmjet formës dhe përmbajtjes u thellua edhe më tej, revolucioni shoqëror mbetej e vetmja alternativë për fshatarësinë për të zgjidhur në favorin e saj këtë kontradiktë.

Sipas interpretimit të mësipërm, pas Shpalljes së Pavarësisë lufta e klasave, që kishte qenë njëherësh edhe luftë çlirimtare, mori një tjetër drejtim. Ajo u krye tashmë në një mjedis të ri. Duke qenë se Shpallja e Pavarësisë ishte një revolucion që zgjidhi detyra politike dhe joekonomike, krijimi i shtetit shqiptar në vitin 1912 i vendosi tensionet ndërklasore në një kontekst të ri politik dhe institucional. Klasat shfrytëzuese, që deri dje shërbenin si vjega të autoritetit osman, pas pavarësisë u shndërruan në klasa të vërteta sunduese, që nuk e ushtronin pushtetin e tyre si të deleguar të Stambollit dhe as mund të fshiheshin pas

²⁷ Frederik Engels, *Lufta fshatare në Gjermani*, Tiranë: 8 Nëntori, 1975, f. 28.

²⁸ G. Shpuza, *Kryengritja fshatare ...*, f. 69.

²⁹ *Po aty*, f. 68.

³⁰ Enver Hoxha, “Disa pikëpamje mbi Kryengritjen e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme ...”, f. 132.

tij. Nga ky moment legjitimiteti i autoritetit të tyre u godit rëndë pasi tashmë, të zbuluar nga ombrella e sulltanit ata u vendosën drejtpërdrejt përballë masave popullore.³¹ Këto të fundit nuk e drejtonin më energjinë dhe pakënaqësinë e tyre kundër pushtuesit të huaj, gjë që e nxori zbuluar klasën e bejlerëve në sytë e fshatarësisë si përvetësuese të punës së saj. Prej këtej, Kryengritja e Shqipërisë së Mesme e vitit 1914-1915, e emërtuar jo më kot si fshatare, mori një rëndësi shumë të madhe për narrativën historike të regjimit komunist shqiptar, pasi ajo i shërbente atij si rasti i parë i një beteje të drejtpërdrejtë klasore ndërmjet fshatarësisë dhe çifligarëve.³² Qëndrimin ndaj kësaj kryengritjeje, Enver Hoxha e bëri të ditur qysh në Kongresin I të PKSh-së, ku ai u shpreh: “Edhe kur vendi ynë fitoi independencën e tij politike nacionale, kryengritjet vazhduan. Luftërat e fshatarësisë me në krye Haxhi Qamilin kundër Esat Pashës e feudalëve të Beratit dhe të Elbasanit tregojnë dëshpërimin dhe urrejtjen e vegjëlisë kundër shtypësve shekullorë”.³³ Këtë qëndrim ai nuk e ndryshoi asnjëherë.

Sipas këtij interpretimi, përpjekjet e vegjëlisë rurale për të shkatërruar pushtetin e çifligarëve synonin ta bënin realitet pavarësinë e vendit dhe Kryengritja e Shqipërisë së Mesme ishte pjesë e pandarë e traditës revolucionare të shqiptarëve. Dallimi në krahasim me të shkuarën osmane ishte se në vitin 1914 fshatarësia u ngrit kundër parisë së tokës në një kontekst të ri politik. Nga krahu tjetër, pavarësisht dasive që ekzistonin brenda gjirit të klasës së çifligarëve dhe ndarjes së saj në segmente të ndryshme politike, të cilat përvijoheshin mbi bazën e rivalitetit për pushtet dhe orientimit të politikës së jashtme,³⁴ elementët e këtij formacioni socio-ekonomik e konsideronin shtetin shqiptar si instrument të regjimit të tyre çifligar.³⁵ Këta e zëvendësuan sulltanin osman me Fuqitë e Mëdha europiane dhe klientelizmi ndaj tyre ishte në funksion të riprodhimit të pushtetit të kësaj klase mbi popullatën e gjerë shqiptare. Prej këtej, kryengritja e vitit 1914 e drejtuar kundër qeverisë së Durrësit dhe Princ Vidit, i cilësuar prej Enver Hoxhës si agjent i

³¹ G. Shpuza, *Kryengritja fshatare ...*, f. 69.

³² *Po aty*, f. 422.

³³ E. Hoxha, *Raport në Kongresin e I-rë ...*, f. 17.

³⁴ *Po aty*, f. 72.

³⁵ *Po aty*, f. 201.

imperializmit gjerman,³⁶ ishte njëkohësisht një goditje kundër imperializmit perëndimor dhe bejlerëve, të cilët kërkonin të përjetësonin pozitën e tyre ekonomiko-shoqërore në vend përmes shërbimeve që ata i bënin politikës së jashtme të Fuqive të Mëdha. Në këto kushte, tehu i luftës së klasave u drejtua sërish drejt një kundërshtari të dyfishtë: nga njëra anë kundër çifligarëve, të cilët si tradhtarë të vendit nxirnin në ankand interesat kombëtarë për të mbrojtur interesat e tyre të ngushtë klasorë duke u bërë agjentë të fuqive të huaja në Shqipëri dhe nga ana tjetër kundër imperializmit evropian, i cili nuk pranonte krijimin e një Shqipërie me të vërtetë të pavarur.

Siç do të shkruante edhe profesor Gazmend Shpuza: “Pas shpalljes së Pavarësisë deri më 1920 kontradiktë kryesore mbeti kontradikta midis popullit shqiptar nga njëra anë, dhe imperializmit, shovinizmit dhe reaksionit politik, çifligar, klerikal dhe bajraktar, nga ana tjetër”.³⁷ Kjo sfidë e dyfishtë mund të zgjidhej vetëm përmes goditjes së bejlerëve dhe sërës së tyre, që ishin shfrytëzues të popullit dhe përçues të interesave të huaj në vend, duke shkatërruar marrëdhëniet e vjetra feudale që përbënin edhe bazën materiale të pushtetit të tyre. “Ata - shkruan Enver Hoxha për kryengritësit e Shqipërisë së Mesme - filluan të shkallmonin pushtetin e vjetër dhe mbeturinat e pushtetit otoman”.³⁸ Profesor G. Shpuza do ta artikulonte edhe më tej këtë qëndrim duke argumentuar se forca shtytëse e kësaj lëvizjeje do të ishte fshatarësia, pasi në këtë kohë, vetëm ajo bashkë me vegjëlinë e qytetit përfaqësonin forcën me të vërtetë atdhetare dhe përparimtare të vendit.³⁹

Sipas kësaj teze, edhe pse kjo kryengritje dështoi, vendi që ajo zinte në historinë e Shqipërisë ishte mjaft i rëndësishëm, pasi përgatiti terrenin e Revolucionit demokratiko-borgjez të Qershorit të vitit 1924, i cili përfaqësonte një fazë më të lartë se kryengritja e fshatarëve të Shqipërisë së Mesme.⁴⁰ Dështimi i këtyre dy lëvizjeve, nxori në pah dobësitë e borgjezisë shqiptare, dhe i hapi rrugën revolucionit të klasës punëtore,⁴¹ e

³⁶ E. Hoxha, “Disa pikëpamje mbi Kryengritjen e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme ...”, f. 111-112.

³⁷ G. Shpuza, *Kryengritja fshatare ...*, f. 71.

³⁸ E. Hoxha, “Disa pikëpamje mbi Kryengritjen e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme...”, f. 110-111.

³⁹ G. Shpuza, *Kryengritja fshatare ...*, f. 63.

⁴⁰ *Po aty*, f. 433.

⁴¹ *Po aty*, f. 434.

vetmja klasë me të vërtetë revolucionare, e cila e përmbushi me sukses detyrën e saj historike. Regjimi komunist pretendonte se ishte përfaqësues i aleancës së kësaj të fundit me klasën fshatare. Pra, qendra gravitacionale e luftës politike dhe konfiguracioneve të saj kishte të bënte me përballjen e bejlerëve dhe parisë së vjetër osmane me segmentet e tjera shoqërore që kërkonin të emancipoheshin dhe të përmbysnin pushtetin e tyre. Ky është edhe thelbi i luftës së klasave, që fillon me fshatarësinë - e shprehur në Kryengritjen e Shqipërisë së Mesme në vitet 1914-1915, vijon me borgjezinë, që arrin pikën kulmore me Revolucionin e Qershorit të 1924-s. Me vendosjen e kompromisit të ashtuquajtur feudal-borgjez të periudhës zogiste, marrëdhëniet kapitaliste përparuan në fshat dhe qytet, me rezultate afatgjata në strukturën sociale dhe jetën politike të vendit, pasi në skenë doli klasa punëtore. Ishte kjo që do të vijonte luftën e klasave kundër aleancës së çifligarëve dhe borgjezëve.⁴²

Lufta e Dytë Botërore u shndërrua në një arenë ku sërish revolucioni kombëtar dhe ai shoqëror u ndërthurën me njëri-tjetrin dhe u zgjidhën përfundimisht. Punëtorët të organizuar politikisht në Partinë Komuniste të Shqipërisë farkëtuan aleancë me fshatarët e varfër e të mesëm dhe i udhëhoqën këta për të përmbyllur me sukses revolucionin e dyfishtë. Pushteti i kaloi më në fund popullit dhe fshatarësia, falë PKSh-së u çlirua.⁴³ Kështu, universalizmi i narrativës historike sovjetike gjen zbatim edhe në Shqipëri, sikundër edhe bashkimi ndërklasor ndërmjet proletariatit dhe vegjëlisë rurale. Të tria këto momente, përfaqësonin pika kyçe të historisë së Shqipërisë së pavarur dhe shënonin kalimin nga njëra fazë në tjetrën. Secila prej tyre poqi kushtet për vendosjen e diktaturës së proletariatit.

Sipas kësaj narrative deterministe, që kishte për gur themeli prezentizmin historik të tipit *post hoc ergo propter hoc* (pas kësaj dhe prej kësaj), Kryengritja e Shqipërisë së Mesme ishte e para ndër këto lëvizje dhe ajo i hapi rrugën ardhjes në pushtet të PKSh-së. Enver Hoxha do ta përmbledhte në këtë mënyrë funksionin që kjo kryengritje do të luante në skemën e përcaktuar prej tij vetë: “Këtu është çështja të

⁴² Mbi çështjen e formimit të klasës punëtore në Shqipëri dhe rolit të saj historik në kryerjen me sukses të revolucionit të dyfishtë kombëtar dhe socialist, shih Kristaq Misha, *Lëvizja punëtore në Shqipëri*, Tiranë: Naim Frashëri, 1970.

⁴³ Agim Muçaj, *Lufta e fshatarësisë kundër shfrytëzimit çifligaro-borgjez 1925-1939 dhe qëndrimi i klasave ndaj saj*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 1990.

përcaktohet drejt karakteri i një momenti të rëndësishëm shqiptar, në një periudhë të rëndësishme të historisë së Shqipërisë, e që do të ketë reperkursione në luftën e mëvonshme të popullit tonë, në rezistencën e popullit kundër regjimit të feudalëve me Zogun në krye, në luftën Nacionalçlirimtare të popullit tonë kundër fashizmit italian, nazizmit gjerman dhe tradhtarëve të vendit.”⁴⁴

Rëndësia që Enver Hoxha i dha Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme lidhet me një varg arsyesh. Së pari, fakti që Shqipëria vazhdoi të ishte një vend thellësisht i prapambetur agrar deri me pushtimin fashist të vendit, ku nuk kishte një klasë të mirëfilltë punëtore, shtroi përpara udhëheqjes së PKSh-së nevojën e gjetjes së një mbështetjeje të gjerë për partinë, e cila mund të sigurohej vetëm në fshat. Qysh gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, udhëheqja e PKSh-së përdori parullën e aleancës së klasës punëtore me atë fshatare, ku e para do të ishte forca pararojë. Kryengritja e Shqipërisë së Mesme do të shërbente si një ngjarje e rëndësishme, si provë për traditën revolucionare të fshatarësisë shqiptare. Në monografinë kushtuar kësaj kryengritjeje, në të cilën bëhej përpjekje për të vërtetuar përmes dokumenteve tezat e Enver Hoxhës, historiani Gazmend Shpuza do të shkruante: “Kryengritjet e mëdha anti-osmane të viteve 1910-1912, shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, kryengritja fshatare e viteve 1914-1915, si dhe lufta çlirimtare antiimperialiste e viteve 1918-1920 tregonin se procesi revolucionar, patriotik dhe antifeudal në Shqipëri ecte përkrah procesit revolucionar ballkanik dhe botëror, që kishte shpërthyer me fillimin e krizës së përgjithshme të kapitalizmit, siç qenë revolucioni rus, kryengritja fshatare në Rumani, revolucioni iranian, revolucioni kinez, revolucioni meksikan, pa bërë fjalë këtu për revolucionin xhonturk, në të cilin populli shqiptar qe pjesëmarrës tepër veprues, proces ky që do të merrte hov me fitoren e Revolucionit të Tetorit”.⁴⁵

Ky pohim dëshmon qartë se regjimi stalinist shqiptar e integronte historinë e shqiptarëve brenda asaj trajektoreje që ata e konsideronin si vijimësi të historisë së përgjithshme të botës. Në këtë mënyrë, si strukturat e prodhimit të dijes ashtu edhe udhëheqësi i PPSH-së, përpiqeshin që të vërtetonin se ardhja e komunistëve në pushtet nuk ishte

⁴⁴ E. Hoxha, “Disa pikëpamje mbi Kryengritjen e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme ...”, f. 103.

⁴⁵ G. Shpuza, *Kryengritja fshatare ...*, f. 433.

aksidentale, se populli shqiptar nuk ishte i shkëputur nga lufta e madhe që po zhvillonin popujt e botës kundër imperializmit. Madje përkundrazi, shqiptarët ishin tërësisht të përfshirë në të. Ishte pikërisht kjo traditë revolucionare, e cila nënkupton se ishte fshatarësia shqiptare, ajo që mundësoi më pas aleancën e kësaj të fundit me PKSh-në. E braktisur dhe e lënë e vetme në luftën e saj kundër çifligarëve, fshatarësia u bind për dobësinë e borgjezisë shqiptare.⁴⁶ Nuk do të vononte dhe vegjëlia rurale do të kuptonte se ajo duhej të shkonte pas së vetmes klasë me të vërtetë revolucionare, proletariatit, gjë që do të kryhej gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pra, kryengritja e viteve 1914-1915 ishte një lëvizje e cila kishte dy detyra: çlirimin e vendit dhe këputjen e prangave klasore, tezë kjo në të cilën shohim analogji me taktikën e ndjekur nga forcat komuniste gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Enver Hoxha donte të vendoste një lidhje historike mes asaj që bëri PKSh-ja dhe një të shkuare historike revolucionare. Kështu, lufta partizane që solli komunistët në pushtet nuk u zhvillua në një truall të virgjër. Gabimet e bëra nga fshatarët e Shqipërisë së Mesme dhe nga lëvizjet e mëvonshme që e pasuan atë, kishin luajtur kështu rolin e edukatorit për lëvizjen punëtore. Madje, ai e paralelizonte këtë kryengritje me programin e PKSh-së kur theksoi se “lufta e rebelëve ishte luftë e popullit kryengritës, prandaj ata janë të popullit, janë të Partisë sonë”.⁴⁷

Narrativa historike ka shërbyer si një nga instrumentet më të fuqishme për regjimin stalinist shqiptar për të legjitimuar pushtetin e tij - dhe këtu rasti shqiptar nuk është aspak një përjashtim - e prandaj ai kërkoi t’ua nënshtronte shkrimin e së shkuarës nevojave të aktualitetit. Udhëheqësi stalinist shqiptar u përpoq të vërtetonte se pushteti që ai mbante ishte rezultat i ligjeve të hekurta të historisë. Duke njësuar veten me regjimin, regjimin me partinë dhe partinë me atdheun, Enver Hoxha mishëroi në personin e tij jo vetëm Shqipërinë dhe socializmin, por edhe të tashmen dhe të ardhmen, të cilat kryheshin njëkohësisht në përputhje me ligjet historike dhe me testamentin e rilindësve. Në këtë mënyrë, udhëheqësi stalinist shqiptar shkriu nacionalizmin shqiptar me teorinë marksiste, pasi kjo i lejonte atij të legjitimonte pushtetin e tij dhe të

⁴⁶ *Po aty*, f. 430-431.

⁴⁷ Ana Lalaj, “Si u ndryshua një tekst historie për Haxhi Qamilin”, *Korrieri*, 10.02.2005, marrë në Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 162.

ashtuquajturën diktaturë të proletariatit në një vend ku nuk kishte ekzistuar asnjë parakusht për të vendosur një regjim i tillë. Sikundër tregon edhe Elidor Mëhilli, nacionalizmi shndërrohet në një konstante me rëndësi kritike sidomos pas prishjes me Bashkimin Sovjetik në vitin 1961. Tanimë, udhëheqja komuniste shqiptare duhej të ndërtonte një hartë të re mendore dhe një traditë patriotike dhe revolucionare të re, që e shkëpuste nga narrativa që ndërtoi gjatë viteve '50, kur marrëdhëniet e Tiranës me Moskën lulëzonin.⁴⁸

E megjithatë, nacionalizmi nuk doli papritur në vitet '60, pasi ai ishte i pranishëm në ligjërimin dhe politikat e regjimit komunist shqiptar qysh në kohën e prishjes me jugosllavët.⁴⁹ Gjatë romancës me Bashkimin Sovjetik ai thjesht iu nënvendos dhe integrua brenda diskursit internacionalist. Pas prishjes me BRSS-në, Hoxha nuk kishte pse ta mbante më të fshehur nacionalizmin, por e përfshiu atë brenda opusit leninist - dhe jo edhe aq marksist. Kjo do të dilte qartë edhe në këshillën që ai u jepte historianëve shqiptarë se si duhej ta bënë punën e tyre. Kështu, në vitin 1962 ai theksoi se historishkruesit duhej të kishin “parasysh dy gjëra me rëndësi në interpretimet e fakteve historike të kësaj periudhe (të viteve 1912-1914 – A.H.): shkrimet e Leninit dhe programin madhështor të rilindësve të Shqipërisë, me epiqendër Sami dhe Naim Frashërin.”⁵⁰ Këto ishin elementet fikse, ndërveprimi mes të cilave do të krijonte boshtin e ndërtimit të narrativës historike të Shqipërisë për periudhën që pasoi Shpalljen e Pavarësisë. Vetëm se duhet pasur kujdes dhe nuk duhet menduar se Enver Hoxha ishte një nationalist, për të cilin marksizëm-leninizmi ishte thjesht një vello e hollë. Në fakt, sikundër duket edhe në citimin e mësipërm, udhëheqësi stalinist shqiptar vendos të parin Leninin dhe pas tij rilindësit, renditje kjo që tregon qartazi hierarkinë e rëndësisë që kishte leninizmi mbi ideologjitë e tjera. Gjithsesi, fakt mbetet se pas vitit 1961, nacionalizmi merr një rëndësi që nuk e kishte gjatë viteve '50.

⁴⁸ Elidor Mëhilli, *From Stalin to Mao: Albania and the Socialist World*, Ithaca & London: Cornell University Press, 2017, f. 219.

⁴⁹ Norman Naimark, *Stalin and the Fate of Europe: the Postwar Struggle for Sovereignty*, Cambridge, MA & London: The Belknap Press of Harvard University Press, 2019, f. 86-87; Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm: KOASH-i dhe regjimi diktatorial shqiptar (1945-1967)*, Tiranë: UET Press, 2017, f. 132-133.

⁵⁰ E. Hoxha, “Disa pikëpamje mbi Kryengritjen e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme...”, f. 101.

Narrativa që ndërthurte determinizmin historik të marksizëm-leninizmit dhe parimin e luftës së klasave me mesianizmin e nacionalizmit vendoste mbi një themel të fortë ideologjik kultin e individit të Enver Hoxhës. Praktiki i kreu i PPSH-së shndërrohej në një *deus ex machina*, një udhëheqës, që ishte produkt i nevojës historike të vendit, të atij vendi që më parë ishte shitur prej elitës politike, e cila kishte nxjerrë në ankand interesat e atdheut për hir të ruajtjes së interesave të ngushtë klasorë. Këtë opinion të tijin mbi elitën politike shqiptare të para 1944-s Enver Hoxha e zbërthente me një frymë të theksuar antiorientaliste qysh në vitin 1948, e cila ishte edhe shprehje e projektit të tij për modernizimin e vendit dhe të shkëputjes së tij prej trashëgimisë osmane - gjë që tregon qartë rolin përcaktues që kishin luajtur në formësimin e botëkuptimit të tij Rilindja shqiptare dhe rrymat nacionaliste ballkanase të shek. XIX. Në Kongresin e Parë të PPSH-së, ai do të thoshte: “Pushteti ishte në duart e bejlerëve të rritur dhe të edukuar në ambientin e perandorisë turke, të rritur me frymë dhe konceptione anadollake. Këta njerës nuk mund të shpinin shoqërinë tonë përpara, sepse këta kishin interesa të kundërta me masat popullore, që i shtynin”.⁵¹ Për të vërtetuar këtë tezë të vetën ai citonte Marks, kur ky i fundit thoshte: “Monarqia nuk mundet kurrë t’a rrezikojë vehten me luftën revolucionare, me kryengritjen e masave, me terrorin revolucionar. Ajo preferon më parë të bashkohet me armikun më të rrezikshëm të popullit se sa të bashkohet me popullin...revoltimi i masave, kryengritja e përgjithëshme e popullit janë mjete që regjimi monarqik ka frikë t’i përdorë”.⁵²

Nisur nga kjo tezë, Enver Hoxha zbërthente qëndrimin e elitës politike ndaj fateve të vendit prej Shpalljes së Pavarësisë deri në vitin 1944 kur thoshte: “Brenda shtetit t’onë klika e Zogut, shtresa e feudalëve, e borgjezisë pasanike tregtare, dhe gjithë pjesa e kulakëve e lidhur drejt për drejt për interesat e saj të klasës me feudalët latifondistë dhe me borgjezinë tregtare dhe pasanike të qytetit, kanë qenë mbështetja kryesore në vënt për Italinë fashiste...Klasa pasanike sundonjëse në vendin t’onë, tek Italia fashiste shihte të vetmin përkrahës, për mbrojtjen e regjimit të saj dhe të pasurive të saja”.⁵³ Siç shihet, Enver Hoxha e absolutizoi

⁵¹ E. Hoxha, *Raport në Kongresin e I-rë ...*, f. 17.

⁵² *Po aty*, f. 29.

⁵³ *Po aty*, f. 31.

përvojën e Luftës së Dytë Botërore dhe qëndrimet e një segmenti të bejlerëve shqiptarë me forcat fashiste dhe naziste me gjithë kursin politik të këtij grupimi në vitet '20-'30. Qysh në fillim të drejtimit të vendit prej tij, udhëheqësi stalinist shqiptar përdori ligjërimin nacionalist për të justifikuar likuidimin nga komunistët të të gjithë këtij grupimi shoqëror.

Në kuadrin e konceptimit dialektik të historisë, ndërsa elita politike e dalë nga periudha osmane përfaqësonte forcat e errëta dhe prapanike, antiteza e saj, bartësja e atdhetarisë së vërtetë dhe mbrojtësja e sinqertë e popullit shqiptar ishte PKSh-ja. Enver Hoxha e cilësonte regjimin e dalë nga Lufta e Dytë Botërore, në krye të të cilit ndodhej, si përmbushës të aspiratave të kahershme të shqiptarëve. Në raportin e mbajtur prej tij në Kongresin I të PKSh-së, ai do të thoshte se nën Partinë Komuniste Shqiptare populli kishte bërë “luftën më të lavdishme...gjatë historisë së tij shekullore”⁵⁴ dhe kjo luftë u justifikua plotësisht pasi “Partija jonë...çoj popullin shqipëtar në fitorjet më të mëdha që ka parë në historinë e tij,”⁵⁵ pasi “Formimi i Partisë ishte fitorja më e shkëlqyer e historisë së popullit t’onë pse ky kishte për herë të parë udhëheqësen e sigurtë të tij, e dalë nga gjiri i tij, e formuar nga djemt e tij, që për të mprojtur interesat e tij do të sakrifikonin gjer në pikën e gjakut të tyre”.⁵⁶

Vendosja e barazimit mes regjimit dhe personit të udhëheqësit garantonte më pas ngritjen e kultit të individit, parakusht kryesor ky për shndërrimin e tij në një figurë të paprekshme. Për rrjedhim kush dilte kundër Enver Hoxhës, identifikohet si armik i regjimit, pra edhe të PPSH-së e të Shqipërisë dhe këta kundërshtarë personalë të udhëheqësit stalinist shqiptar emërtoheshin jo vetëm si armiq por edhe si reaksionarë pasi ngriheshin kundër ligjeve të historisë, kundër sakrificave dhe theroreve të kryera nga shqiptarët. Sa më të mëdha të ishin sakrificat e shqiptarëve, aq më i legjitimuar ishte pushteti i Enver Hoxhës. Prej këtij rridhte edhe nevoja për të nxjerrë tezën se “populli shqiptar e ka çarë historinë me shpatë në dorë”. Pra, shqiptarët dilnin një popull që kishin sakrifikuat gjatë gjithë historisë dhe kishin luftuar për lirinë, e cila mernte kuptim vetëm me krijimin e një shteti të pavarur shqiptar të drejtuar nga komunistët. Gjaku i derdhur prej dëshmorëve të rënë në luftë nuk mund të tradhetohej dhe këtë e garantonte vetëm PPSH-ja, e cila identifikohet me

⁵⁴ *Po aty*, f. 23.

⁵⁵ *Po aty*, f. 6-7.

⁵⁶ *Po aty*, f. 49.

Enver Hoxhën. Qëllimi i gjithë kësaj narrative ishte që, sikurse shkruan edhe Rexhep Qosja, përmes mitizimit të së shkuarës dhe historisë, të mitizohej edhe aktualiteti.⁵⁷

Veç kësaj, Kryengritja e Shqipërisë së Mesme kundër Vilhelm Vedit interpretohej prej Enver Hoxhës si një luftë çlirimtare. Në rast se kjo lëvizje cilësohej si reaksionare dhe antishqiptare, atëherë përfundimi logjik ishte që ajo ishte antishqiptare edhe sepse u drejtua kundër Vedit, i cili ishte i dërguari i Fuqive të Mëdha, fuqive imperialiste, gjë që nënkuptonte se këto Fuqi të Mëdha kishin dashur të mirën e Shqipërisë, e cila ishte e papranueshme për Enver Hoxhën. Përpos të tjerash, një tezë e tillë nënkuptonte se në personin e Vilhelm Vedit identifikoheshin pavarësia e Shqipërisë. Një gjë e tillë do të vinte në pikëpyetje dy elemente të rëndësishme. *E para*, se ishin Fuqitë e Mëdha që i dhanë pavarësinë Shqipërisë, e cila binte ndesh me një nga shtyllat kryesore të metodës marksiste, sipas së cilës lëvizjet e mëdha historike ishin produkt i forcave të brendshme. *Së dyti*, kjo tezë linte të nënkuptonte se këto Fuqi ishin dashamirëse ndaj shqiptarëve, që kundërshtoheshin prej Hoxhës dhe narrativës së rrethimit me armiq dhe bllokadës së imperializmit dhe revizionizmit.

Këto dy shtylla janë të lidhura në mënyrë të ndërsjellë. Një nga parimet bazë të metodës marksiste-leniniste në shkrimin dhe interpretimin e historisë ishte se në zanafillë të zhvillimit të ngjarjeve të mëdha historike qëndrojnë forcat e brendshme. Raporti mes forcave të jashtme dhe të brendshme, prej të cilave prodhohen këto ngjarje, anon nga këto të fundit. Janë pikërisht forcat e brendshme ato që luajnë rolin vendimtar.⁵⁸ Për këtë arsye, nëse pohohej se ishin Fuqitë e Mëdha ato që shpallën pavarësinë e Shqipërisë, binte poshtë sentenca e famshme e Enver Hoxhës se “populli shqiptar e ka çarë historinë i vetëm dhe me shpatë në dorë”. Vënia në pikëpyetje e tezës, se shqiptarët kishin luftuar pandërprerë kundër të gjithë armiqve të jashtëm dhe të brendshëm, do të vinte në dyshim luftën e klasave që zhvillohej brenda vendit, e cila bëhej jo vetëm në emër të ideologjisë por edhe të patriotizmit, pasi ajo e drejtonte tashmë e saj kundër shtresës së pasur të cilësuar si tradhtarë dhe shërbëtorëve të huaj. Për rrjedhim, rrëzohej teza e dytë se Shqipëria ishte e rrethuar me armiq. Nëse dilte se faktori ndërkombëtar kishte ndihmuar

⁵⁷ D. Egro, *Historia dhe ideologjia*,..., f. 206.

⁵⁸ *Po aty*, f. 97.

Shqipërinë që të fitonte pavarësinë, atëherë tronditej narrativa e Enver Hoxhës që justifikonte izolimin gjithnjë e më të madh si një dukuri që kishte qenë konstante e historisë së shqiptarëve.

Historia i shërbente qëllimeve dhe politikave të regjimit stalinist, i cili synonte të shtonte dyshimin ndaj të huajve në mënyrë që populli të miratonte politikën e jashtme izolacioniste të udhëheqësit të PPSH-së. Kështu Enver Hoxha, në punimin e tij kushtuar problemit të Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme do të shkruante: “Fuqitë e mëdha imperialiste të Evropës edhe në këtë periudhë për të cilën po shkruaj, por edhe në periudhat e tjera, kanë patur synime grabitqare...në kurriz të popujve. Luftën e popullit shqiptar, qëllimin e kësaj lufte, jo vetëm e përçmonin dhe e bastardonin, por e fshihnin, e errësonin, ose e shfrytëzonin për interesat e tyre. Shqipëria dhe populli shqiptar për ta nuk ekzistonin,”⁵⁹ se “mund të thuhet se në këtë kohë populli shqiptar nuk kishte asnjë mik që ta mbështeste. Ai duhej të luftonte vetë, me armë, me diplomaci dhe me çdo mjet në këtë situatë të vështirë”,⁶⁰ dhe më tej do të vazhdonte: “Mik i vërtetë i pavarësisë së Shqipërisë atëherë ishte vetëm populli shqiptar me luftën dhe përpjekjet e tij për t’u çliruar me armë në dorë.”⁶¹

Nga ana tjetër, arsyen pse ata që ai quan si historianë borgjezë e kanë emërtuar këtë kryengritje si reaksionare, antikombëtare, proturke dhe antishqiptare i gjen te përpjekja e tyre për të ngritur jo vetëm rolin e Fuqive të Mëdha, por edhe për të nxjerrë në pah dashamirësinë e tyre ndaj çështjes shqiptare. “Borgjezia dhe historianët e saj, - shkruan ai - si brenda dhe jashtë vendit, janë përpjekur dhe përpiqen “të vërtetojnë” se kjo kryengritje lindi si reaksion dhe kundër “konsolidimit” të shtetit shqiptar të porsalindur dhe që merrte formë nën kurorën e mbretit gjerman, Princ Vidit.”⁶² Ky i fundit ishte “agjent i imperializmit gjerman”⁶³ dhe kush mbështeste Vidin mbështeste njëkohësisht edhe politikën e fuqive imperialiste.⁶⁴ Për E. Hoxhën princi prusian përfaqësonte padrejtësitë që fuqitë europiane kishin kryer ndaj shqiptarëve dhe ai simbolizonte ripushtimin e Shqipërisë. Siç do të

⁵⁹ E. Hoxha, “Disa pikëpamje mbi Kryengritjen e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme ...”, f. 97-98.

⁶⁰ *Po aty*, f. 98.

⁶¹ *Po aty*, f. 104.

⁶² *Po aty*, f. 105.

⁶³ *Po aty*, f. 111-112.

⁶⁴ *Po aty*, f. 112.

shprehej edhe në analizën që i bëri Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme, “ardhja e Vidit nuk duhet konsideruar si një akt pozitiv, po si një koniunkturë e shteteve të fuqishme të Antantës dhe Evropës Qendrore për përgatitjen e luftës së madhe botërore. Në një kohë kur po përgatitej kjo luftë, duhet të ishte naiv që të thoshe se qeveria e Vidit që me të vërtetë një qeveri pozitive”.⁶⁵

Teza e Enver Hoxhës mbi Kryengritjen e Shqipërisë së Mesme, si një lëvizje që gërshetonte luftën çlirimtare me atë klasore kundër çifligarëve, u pasqyrua menjëherë në tekstin zyrtar të Historisë së Shqipërisë ku theksohej: “Kryengritja kundër princ V. Vidit dhe kryengritja kundër Esat Pashës janë trajtuar si një lëvizje e vetme, të nisura dhe të zhvilluara nga fshatarësia e Shqipërisë së Mesme, me të cilën u bashkuan edhe bujqit fshatarë të krahinave të tjera, kundër çifligarëve, për tokë, si dhe kundër ndërhyrjes imperialiste dhe agresionit shovinist. Lufta e fshatarëve në dy fronte u përcaktua nga pleksja e këtyre dy detyrave të rëndësishme historike kombëtare dhe shoqërore.”⁶⁶ Pra, kjo kryengritje ecte në përputhje me parimin marksist-leninist të luftës si e vetmja zgjidhje për të ndërtuar një shoqëri të re. Kjo është arsyeja pse Hoxha e cilësoi këtë kryengritje si revolucion.⁶⁷

Si përfundim, përmes kësaj sprove nuk kam treguar vetëm se historia është e lidhur ngushtësisht me politikën. Qysh në krye të herës, kur kjo fushë e dijes u shndërrua në një lëmë akademik, ajo ka qenë e ngjizur me pushtetin dhe ende vijon të mbesë një hapësirë tejet e debatuar e qasjeve të ndryshme që frymëzohen ideologjikisht e politikisht. Kushdo regjim socio-ekonomik e ideologjik krijon një univers të tijin të vlerave, të së mirës e të së keqes, të pranueshmes e të papranueshmes, të cilat krijojnë një kornizë interpretimi për historianët, edhe atëherë kur ata nuk janë të vetëdijshëm për këtë. Qëllimi i këtij punimi është për të treguar se si konkretisht, në kontekstin stalinist shqiptar u ndërtua një skemë e caktuar e interpretimit të historisë, që u shërbente nevojave të udhëheqjes komuniste shqiptare. Ndërtimi i metanarrativës së historisë së Shqipërisë kërkonte të pajtonte marksizëm-leninizmin me nacionalizmin dhe gjetja e një ekuilibri mes tyre ishte shumë e vështirë, sidomos për historianët, të cilët kishin si pikënisje të tyre nacionalizmin. Kjo dukuri ishte shprehje

⁶⁵ *Po aty*, f. 123.

⁶⁶ *Historia e Shqipërisë ...*, vëll. III, f. 36.

⁶⁷ E. Hoxha, “Disa pikëpamje mbi Kryengritjen e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme ...”, f. 128.

e sfidës që paraqiste vetë ligjërimi nacional-komunist dhe krijimi i sintezës ndërmjet një ideologjie që i mëshonte internacionalistes dhe një tjetre që glorifikonte specifikën. Do të ishte vetë Enver Hoxha ai që ndërhyri personalisht dhe u tregoi historishkruesve shqiptarë se si ta gjenin formulën e pajtimit. Duke i dhënë përparësi më të madhe leninizmit në raport me nacionalizmin, udhëheqësi stalinist shqiptar bëri të qartë se historia e Shqipërisë do të ishte së pari leniniste dhe pastaj nacionaliste, sikundër ishte edhe vetë regjimi komunist-nacional i PPSH-së.

S u m m a r y

IDEOLOGY, POLITICS, AND HISTORY: THE CASE OF CENTRAL ALBANIA'S UPRISING (1914-1915)

This article explores the use (and misuse) of history in communist Albania. History is linked through many threads with politics and its writing, and regardless of the efforts of many historians to depoliticize their work, continues still to be largely a political act. In this sense, the writing of history during communism is not an exception from a general rule. However, as it is the case in dictatorships, the politics and ideology are not merely generated by the historians themselves but are dictated from the political authorities, sometimes even from the leadership. This was the case in communist Albania, and the revolt that took place in Central Albania in 1914-1915 was a case in point. It was Enver Hoxha himself who laid down the main thesis on how the historians had to analyze this revolt. Indeed, the Albanian Stalinist leader considered history as a powerful tool to legitimize his power and the communist takeover in Albania at the end of World War Two. Merging Marxist-Leninist historical model with nationalism E. Hoxha constructed a narrative that aimed at proving that the establishment of the Albanian Communist Party (after 1948 renamed Albanian Labor Party) and its coming to power was not an accident but rather the fulfillment of the logic of history. For this reason, E. Hoxha wanted to prove that there were historical antecedents to the communist-led resistance of WWII. The Revolt of Central Albania that took place in 1914-1915 was one of those key revolutionary moments. This uprising had a pronounced Islamic tint and its targets became Prince Wilhelm Wied, the Prussian noble that the European Powers appointed at the head of the newly-founded Albania, and the Albanian landed nobility, which supported the prince. According to the ALP's leader, the uprising of 1914-1915 was a peasants'

movement against their landlords, where class struggle and liberation war merged into one single denominator. Comparing this insurrection with the German Peasant Revolt of the XVI century, Enver Hoxha argued that behind the religious slogans hid a political program and Islam provided the peasants with a language to expose their goals. This rebellion, he argued, failed because the bourgeoisie, which entered in an alliance with the landed aristocracy, did not support the peasants. The true liberation of the peasantry would come during the WWII, when it entered in alliance with the working class. In this way, E. Hoxha constructed for Albania a replica of the Soviet unilinear and universal historical narrative disregarding the local dynamics and particularities.

